



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Departamenti për Profesione të Lira-Department of Freelance Professions  
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.24/2022

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, **P.nr.181/2019**, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Burbuqe Spahija-Kerveshi, përfaqësuesi i palës ankuese nga ,av. nga dhe Përmbarduesi Privat, me datë 23.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHEN** Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-24/2022 i datës 15.08.2022 dhe ankesa e palës ankuese nga e datës 01.08.2022, **si të pabazuara.**

**II. Përmbarduesi Privat**, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore, P. nr.181/2019.

**A r s y e t i m**

Me datën 01.08.2022 pala ankuese, përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar ankesë ndaj përmbarduesit, me pretendimin se përmbarduesi privat në kundërshtim me dispozitat ligjore ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbardimore, pasi ka dërguar në zyren kadastrale në Fushë Kosovë kërkesë për shënim të përmbardimit në ngastrën kadastrale,

P-72514011-00495-10, e cila pronë sipas përmbauesit është e evidentuar në emër të \_\_\_\_\_, ndërsa ajo paluajtshmëri sipas ankuesit është pronë e \_\_\_\_\_. Njoftimin për vendosje të barrës pala ankuese e ka kuptuar nga zyra kadastrale dhe me kërkesë të palës ankuese është nxjerrë historiat i parcelës, ku në bazë të dokumentacionit kadastral shihet se paluajtshmëria lëndore i takon palës \_\_\_\_\_ e jo debitorit në këtë lëndë.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i palës ankuese ka deklaruar se është i vetmi i autorizuar në këtë lëndë, se mbetet në tërësi pranë ankesës, duke kërkuar edhe që komisioni të bëjë kërkesë zyrtare tek Agjencioni Kadastral lidhur me historiatin e pronës që është objekt përmbarimi këtu dhe pas raportit të kërkoj lirimin nga barra të kësaj prone nga ana e përmbauesit privat.

**I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndërmirren masa ndaj përmbauesit privat duke i shqiptuar masën e ndalimit të profesionit për periudhë prej 3 muaj deri në një vit, bazuar në dispozitat e nenit 368, par.1 nën par.1.4 të LPP-së.**

Me datën 15.08.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbauesit privat, lidhur me veprimet përmbaimore për këtë lëndë.

Përmbauesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore ka theksuar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në ankesë, duke shtuar se në shkresat e lëndës palë në procedurë në këtë rast e ka \_\_\_\_\_ përfaqësuesin e kompanisë së debitorit, ku është edhe prokura në shkresat e lëndës. Poashtu ka theksuar se \_\_\_\_\_ ka qenë në zyrën e tij me avokatin \_\_\_\_\_ dhe se të njëjtët kanë ushtruar mjetet e tyre juridike sipas prapësimit dhe ankesës, në të dy shkallët dhe janë refuzuar. Propozimi për përmbarim rrjedhë nga kontrata për shitëblerje të kësaj kompanie \_\_\_\_\_, e nënshkruar te noteri \_\_\_\_\_ me dt.14.12.2017. Shitës i kësaj kompanie është \_\_\_\_\_, ndërsa blerës \_\_\_\_\_, prandaj edhe propozimi për përmbarim është paraqitur për kreditorin \_\_\_\_\_, ndaj debitorit \_\_\_\_\_.

Pasi kanë përfunduar procedurat për mjetet juridike, prapësim dhe ankesë, ka vepruar dhe para komisionit prezantoi pasqyrën e çasjes si përmbaues në programin e Agjencionit Kadastral, ku figuron se pronar i paluajtshmërisë është debitori, \_\_\_\_\_, e jo pala \_\_\_\_\_ Prona është evidentuar sipas kërkesës për bizneset dhe shoqëritë tregtare me numrin e biznesit që figuron edhe në regjistrin e biznesve-ARBK.

Në vazhdim përmbauesi ka shtuar se në rastin konkret meqenëse e ka pasur rastin me biznes, e ka kërkuar numrin e biznesit, ndërsa pjesa tjetër e veprimeve të avokatit prezent që përfaqëson palën ankuese, \_\_\_\_\_ te cilin sipas shkresave që rrjedhin nga kontrata, si përmbaues nuk e ka pasur palë në procedurë.

**I ka propozuar komisionit që të refuzohet ankesa e palës ankuese.**

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbauesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërin nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së,

Këtë konstatim komisioni e bazon në shkresat e lëndës që gjinden në këtë rast. Shihet se palë debitore është \_\_\_\_\_ e jo pala ankuese. Nuk është kontestues deklarimi i palës ankuese ku shihet se në një certifikatë pronësie figuron pronar pala ankuese \_\_\_\_\_ por nga provat e



parashtruara nga përmbauesi figuron se kjo paluajtshmëri figuron sipas sistemit elektronik që ka gjeneruar përmbauesi nga Agjencioni Kadastral, ajo pronë figuron edhe si pronë e debitorit në këtë rast.

Komisioni nuk ka kompetencë të verifikoi vërtetësinë e ketyrë dokumentacioneve, pasi të dy certifikatat janë ofruar nga Agjencioni Kadastral, por njëra me kërkesë fizike direkt në zyrë kadastrale, ndërsa tjetra përmes sistemit elektronik të shfrytëzuar nga përmbauesi. Komisioni nuk ka kompetencë të kërkoj historiat e as të parashtrroj kërkesë tek Agjencioni Kadastral, por vendos në bazë të provave të ofruara nga palët.

Nga këto prova vërehet se shënimin e përmbaimit, përmbauesi e ka bërë duke u bazuar nga të dhënat që i ka ofruar sistemi i Agjencionit kadastral, në të cilin kanë çasje të gjithë përmbauesit.

Në Konkluzionin, P.nr.181/2019 të dt.08.03.2021, për shënim të përmbaimit është cekur që shënimin e përmbaimit duhet të vendoset për pronën e paluajtshme që është në pronësi të debitorit dhe e cila është paluajtshmëri lëndore, e jo për paluajtshmërinë e palës ankuese.

Agjencioni, respektivisht zyra kadastrale do të duhej të sqaronte me përmbauesin, pronësinë e njësisë kadastrale, bazuar në kërkesën e përmbauesit dhe të kërkonte sqarime se si ka mundësi që në kërkesë ka figuruar pronar debitor, ndërsa shënimin e kanë orientuar vetëm në numër të njësisë kadastrale, pa shikuar fare kërkesën e përmbauesit që lidhet me debitorin dhe tërë pasuritë e tij si debitor.

Pretendimi i palës ankuese se përmbauesi ka bërë shënim përmbaimit në pronën e tij, nuk qëndron, sepse kërkesa e përmbauesit drejtuar zyrës kadastrale ka qenë vendosja e barrës në pronën e debitorit që e ka evidentuar në sistemin elektronik të Agjencionit Kadastral, ku shihet që ajo njësi kadastrale është pronë e debitorit e jo e palës ankuese. Andaj, komisioni vlerëson se përmbauesi nuk ka përgjegjësi në lëshimet eventuale të sistemit apo institucionit të cilit i është drejtuar për shënim të përmbaimit, por duhet vetë institucioni të kërkonte sqarime nga përmbauesi dhe mos të vepronte.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## **KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**

**DPL.nr.24/2022 datë 23.09.2022**

**Kryesuesja e Komisionit Disiplinor**

Manushe Karaci



***KËSHILLË JURIDIKE:*** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.